

Boshurë informacioni

Viza/Lejeqëndrimi

Studentëve shtetas të vendeve jashtë EU-së/EEEA-së ju nevojitet lejeqëndrim (Aufenthaltsbewilligung-Student) për të studiuar në Austri për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj. Nëse dëshironi të studioni këtu për më pak se 6 muaj, ju nevojitet të bëni kërkesë për vizë.

Ju mund të aplikoni për lejeqëndrim në ambasadën apo konsullatën e Austrisë në vendin tuaj ose në institucionin përkatës në Austri pasi të keni hyrë legalisht.

Kartela e lejeqëndrimit lëshohet nga autoriteti lokal përgjegjës. Në Graz autoriteti përgjegjës është „Amt der Steiermärkischen Landesregierung“.

Për të aplikuar për lejeqëndrim iu duhen dokumentet si në vijim:

- Dokument udhëtimi (p.sh. pasaportë)
- Çertifikatë e lindjes ose një dokument tjetër ekuivalent me të
- Foto (me ngjyra dhe me përmasa 3.5 x 4.4 cm)
- Vërtetim nga universiteti i cili iu ka pranuar
- Vërtetim për mjete financiare të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës:
- Vërtetim i sigurimit shëndetësor
- Vërtetim i mjeteve financiare (para së gjithash vërtetim i pagës, pensionit, kontrata etj.)
- Në raste të veçanta mund të jenë të nevojshme edhe dokumente të tjera

Studentët nën moshën 24 vjeçare: 533.85 Euro/muaj

Studentët nga moshën 24 vjeçare: 966.65 Euro/muaj

Çiftet: 1472.00 Euro/muaj për të dy bashkë

Për çdo fëmijë shtesë 149.15 Euro/muaj

Lejeqëndrimi vlen për një vit. Pas një viti duhet të parashtrahet kërkesa e vazhdimit të tij.

Lejeqëndrimi mund të vazhdohet nëse përmbushet kriteri i arritjes së 16 ECTS gjatë 1 viti universitar.

Për më shumë informata vizitoni webfaqen:

<https://oead.at/en/to-austria/entry-and-residence/residence-permit-student-no-mobility-programme/>

Nëse ju nevojitet tjetër lloj lejeqëndrimi ose vize, klikoni më poshtë dhe ndiqni udhëzimet për më shumë informata:

<https://oead.at/en/to-austria/entry-and-residence/>

Më shumë detaje mund të gjeni këtu (linku në gjuhën gjermane dhe angleze):

https://www.oesterreich.gv.at/themen/leben_in_oesterreich/aufenthalt/3/2/1/1/Seite.120121.html

<https://studyinaustria.at/en/useful-tips/questions-and-answers/visa/>

Vërejtje: disa shtete të Evropës, siç është p.sh. Britania e Madhe, nuk janë pjesë e zonës Shengen prandaj duhet të keni parasysh se mund të ju duhet vizë e veçantë hyrë në këto shtete ose për t'u kthyer në Austri nga këto shtete.

Programet parauniversitare

Programet parauniversitare janë programe të përgatitjes për provime shtesë, të cilat mund të jenë të nevojshme para fillimit të studimeve. P.sh. mund të vijohet kursi i gjuhës gjermane ose edhe kurse të biologjisë, kimisë, anglishtes etj. Një kurs i gjuhës mund të vijohet edhe kur duhet të arrihet një nivel i caktuar i gjuhës si kriter për t'i filluar studimet.

Më shumë informata mund të gjeni këtu:

<https://vorstudienlehrgang.at/en/graz/>

Pranimi në universitet

Kusht i pranimit në fakultetin e mjekësisë në Graz është arritja e pikëve të mjaftueshme në provimin pranues "MedAt". Pas kalimit të këtij provimi mund të vazhdohet me procesin e regjistrimit:

<https://www.medunigraz.at/humanmedizin/zulassung/internationale-vorbildung/>

Informata për provimin pranues mund të gjeni këtu:

<https://www.medunigraz.at/aufnahmeverfahren-zahnmedizin/aufnahmeverfahren-humanmedizin/>

Tarifa e studimit

Studentët e rregullt të cilët janë shtetas të vendeve të treta duhet të paguajnë një shumë prej €726,72 në semestër. Krahas kësaj të gjithë studentët duhet t'i paguajnë shoqatës së studentëve "ÖH" një shumë prej €20,20 (ÖH Beitrag) në semestër.

Deri së fundmi ka qenë e mundur që shuma prej €726,72 t'i rikthehet studentit pasi të jenë arritur më së paku 16 ECTS gjatë një semestri. Gjithsesi nuk është e qartë nëse kjo mundësi do të ekzistojë edhe në të ardhmen. ÖH po bën përpjekje të mbahet rregull i vjetër.

Më shumë informata për studentët e rregullt të cilët janë shtetas të EU/EWR ose të Zvicrës, të vendeve të botës së tretë dhe për studentët jo të rregullt mund të gjeni këtu:

<https://www.medunigraz.at/service-und-information/studienbeitrag/>

Vaksinat

Vaksinat janë parakusht i praktikave në spitalet e Austrisë. Kjo do të thotë që iu duhen vërtetime përkatëse për vaksinat e marra. Formularin e gjeni në linkun e tretë mëposhtë.

Vaksinat e nevojshme janë:

- Fruthi, Shytat, Rubeola (MMR)
- Variçela
- Hepatiti B

Nëse i keni marrë këto vakcina më herët si dëshmi mund të shërbejë sasia e antitropave në gjak . Nëse keni mjaftueshëm antitropa, një rivaksinim nuk është i nevojshëm.

Personat nga vende të caktuara përveç vaksinave duhet të dëshmojnë se nuk janë të infektuar me tuberkulozë.



E këshillueshme është edhe vaksina kundër FSME, sepse në rajonin e Stirisë por dhe në gjithë Austrinë numri i rriqërave të infektuara me këtë virus është i madh.

Më shumë informata mund të gjeni këtu:

<http://www.oehmedgraz.at/services/impfungen>

<https://www.medunigraz.at/humanmedizin/zulassung/infektionsschutz-anforderungen/gratis-impfungen/>

https://www.medunigraz.at/fileadmin/studieren/zulassung/pdf/infektionsschutz_informationsblatt.pdf

Formularin për vërtetimin e vaksinave e gjeni më poshtë:

https://www.medunigraz.at/fileadmin/studieren/zulassung/pdf/infektionsschutz_anforderungen_formular.pdf

Vendbanimi

Universiteti i Graz-it nuk siguron vendbanimin e studentëve ose personave, të cilët vijnë për të mbaruar një praktikë.

Një listë të konvikteve në Graz mund t'ju gjeni këtu:

<https://www.studium.at/studentenheime/steiermark/graz>

Nostrifikimi

Nostrifikimi i referohet njohjes së diplomave nga ana e universitetit.

Gjatë procesit të nostrifikimit, personi në fjalë konsiderohet student jo i rregullt ("außerordentlicher Studierender"). Për më shumë informata rreth nostrifikimeve, klikoni më poshtë:

<https://www.medunigraz.at/humanmedizin/nostrifizierung/>

Pyetjet rreth këtyre procedurave mund t'ju adresoni në:

[**oeh-ausland@medunigraz.at**](mailto:oeh-ausland@medunigraz.at)

Organizimet e ÖH-së

Informata rreth organizimeve të ÖH-Med Graz i gjeni në gazetën tonë, të cilën ua dergojmë rregullisht studentëve në email adresë, si dhe në Facebook, Instagram dhe nga posterat e ndryshëm në kampusin universitar e në ZMF. Ne organizojmë ligjërata dhe prezantime, shfaqje filmash, evente sporti, workshop-e (p.sh. rreth barazisë, integritetit social etj.) dhe projekte siç është p.sh. "Programi i vaksinimit" kundër virusit influenza dhe aksioni i reparimit të biçikletave. Për studentët e huaj ka organizime si „International Café", "Erasmus Welcome Day" dhe "Intercultural Get-together. Shpresojmë të ju takojmë në këto evente!



Fondet sociale

Studentët të cilët gjenden në kushte të vështira financiare do të mbështeten nga fondi social i shoqatës së studentëve (Sozialfond der ÖH Med Graz). Të gjithë studentëve të cilët paguajnë shumën “ÖH Beitrag” të lartpërmendur mund t’iu ofrohet mbështetje financiare. Studentët duhet t’i përmbushin kushtet e caktuara në mënyrë që të marrin mbështetje financiare.

Më shumë informata mund të gjeni në:

<http://www.oehmedgraz.at/sozialleistungen/sozialfonds-oeh-med-graz>

Shoqata kombëtare e studentëve të Austrisë ka poashtu fondin e saj social.

Për më shumë informata:

<https://www.oeh.ac.at/en/service/funding-pool>

Lista e kontakteve me rëndësi

Për studentët e programit Erasmus është përgjegjëse zyra për marrëdhënie ndërkombëtare e fakultetit të mjekësisë në Graz

<https://international-office.medunigraz.at>

Kontakte me rëndësi për pyetje rreth studimit, vizës/lejeqëndrimit, regjistrimit dhe më shumë:

Njësia për marrëdhënie ndërkombëtare dhe integrim në ÖH Med Graz:

oeh-ausland@medunigraz.at

Njësia për këshillimin e studentëve:

oeh-beratung@medunigraz.at

Njësia për politikën dhe çështjet sociale (p.sh. rreth pyetjeve për fondin social):

oeh-sozial@medunigraz.at

Zyra e ÖH Med Graz:

oeh-sekretariat@medunigraz.at

Ne shpresojmë se kjo broshurë iu ka ndihmuar të informoheni! Për pyetje eventuale na kontaktoni!

ÖH Med Graz